



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1041/22

**GJYKATA KOMERCIALE** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Operatori Ekonomik “G...E...” Shpk me numër të regjistrimit të biznesit ..., me pronar J.K., me seli në Kaçanik, rruga “...” pa nr, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.O., avokat nga K...P...LLC me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.M., Udhëheqës i Sektorit për Mbikqyrjen e legjislacionit në DL pranë të paditurës, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1427/2018 të datës 12.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.03.2023, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e paditësit Operatori Ekonomik “G...E...” Shpk me seli në Kaçanik e datës 24.11.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1427/2018 të datës 12.10.2021, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin e ankimuar ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit Operatori Ekonomik “G...E...” Shpk me numër të regjistrimit të biznesit ... me pronar J.K. me seli në Kaçanik. me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) me seli në Prishtinë, me referencë: KE-334/18 të datës 29.05.2018. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditësit, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes

faktike shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë të prish aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 12.10.2021 me shenjë A.nr. 1427/2018 dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, Aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjen se;

**Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr. Ref: KE-334/18 të datës 29.05.2018, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: I.Shkëputet kontrata me Ref: KE-977/15 e datës 14.12.2015 dhe annex kontrata me ref: KE-236/17 datë 26.04.2017 të lidhura ndërmjet APK-së dhe OE “G...E...r” shpk me seli në Kaçanik me NRB ... të cilën e përfaqëson z.J.K., po ashtu shpallet nul pëlqimi me ref: DP-APK-671/15 datë 14.08.2015, për shkak se pala OE “G...E...r” sh.p.k. nuk iu ka përmbajtur kontratës të cilën e ka kontraktuar me APK, duke tejkaluar sipërfaqen e kontraktuar në ngastrën kadastrale 475-0 në sipërfaqe prej 5.00.00 ha, sa e ka pasur në shfrytëzim e duke e zgjeruar sipërfaqen në 2.23 ha në total prej 7.23 ha duke dalur jashtë vijave kufizuese të kordinatave që parashihet me kontratën me ref: KE-977/15 e datës 14.12.2015 që d.m.th se në sipërfaqen prej 2.23 ha ka bërë shfrytëzim pa kontratë dhe pëlqim me APK.Në pikën II.Obligohet OE “G...E...r” sh.p.k me seli në Kaçanik me NRB ... që pas marrjes së këtij vendimi të liroj pronën nga mjetet dhe njerëzit dhe ta kthej të njejtën në gjendje të mëparshme duke zbatuar planin e rikultivimit për tërë sipërfaqen e shfrytëzuar në afat prej 30 ditësh. Në pikën III. Obligohet DKR –APK në Ferizaj dhe DIQPGJ, që sipas akteve ligjore të merr të gjitha masat ligjore për lirim të pronës, mbikqyrjen e zbatimit të planit të rikultivimit si dhe inkasimin e mjeteve financiare, për çdo mos zbatim të këtij vendimi të merren të gjitha masat e nevojshme ligjore. Në pikën IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv të APK-së. Dhe nën pika V. vendimi ti dërgohet OE “G...E...” shpk me seli në Kaçanik me NRB ..., Drejtoratit Kordinues Rajonal të APK-së në Ferizaj, KK Kaçanik, DIQPGJ dhe arkivit.

Paditësi, i pa kënaqur me këtë vendim ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, kundër të paditurit MBPZHR-APK në Prishtinë, duke

pretenduar se vendimi i tij është jo ligjor. Gjykata e shkallës së parë, për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor më dt.12.10.2021, në prani të të aurizuarëve të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, si të pa bazuar, sipas konkludimeve si në arsyetim se; me vendimin e Agjencisë Pyjore të Kosovës pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë DHE Zvillimit Rural Ref: KE-334/18 e datës 29.05.2018 është vërtetuar fakti se Operatori Teknik “G...E...” Shpk me nr. të regjistrimit të biznesit ..., me pronar J.K., me seli në Kaçanik i është shkëputur kontrata Ref: KE-977/15 e lidhur me datën 14.12.2015 dhe aneks kontrata (për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës pyjore) e lidhur me datë 26.04.2017- të dyja kontratat të lidhura në mes të palëve kontraktuese dhe po ashtu janë shpallur nule akt-pëlqimi me ref: DP-APK-671/15 i datës 14.08.2015, për shkak se paditësi nuk iu ka përmbajtur normave kontraktuese. Gjykata ka vërtetuar faktin se vendimi kontestues me Ref: KE-334/18 i datës 29.05.2018 i lëshuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që në rastin konkret kontrata e lidhur në mes palëve kontraktuese konsiderohet ligj dhe e njejta duhet të zbatohet me përpikëri nga te dyja palët, ashtu si për nga lënda apo objekti i kontratës, prandaj me këtë rast vendimi kontestues i të paditurës është në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 1 paragrafi (2) nën paragrafi 2.1 neni 3 paragrafi 7.4 I Ligjit nr. 03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003.03 për pyjet e Kosovës. Po ashtu gjykata vlerësoj me kujdes edhe pretendimet e të autorizuarit të paditësit të dhëna në padi si dhe në parashtrësën e datës 07.07.2021 lidhur me arsyetimin e besueshmërisë së kërkesëpadisë, mirëpo të njejtat parashtrësia dhe prova të ofruara nuk u morën për bazë për pranim, prandaj lidhur me pretendimet e parashtruara si në padi, u konstatua se në konflikt administrativ ato nuk kanë ndikim në marrjen e një vendimi tjetër, sepse përgjatë procedurës e në bazë të provave të administruara dhe në vështrim të dispozitave ligjore dhe kontraktuale të lartcekura është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendja faktike e çështjes juridike se e paditura ka vepruar drejtë me rastin e nxerrjes së vendimit me ref’ KE-334/18 të datës 29.05.2018 duke i aplikuar në mënyrë adekuate dispozitat materiale dhe procedurale. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në këtë çështje administrative në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja nga e paditura janë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat nga ligji material me rastin e shkëputjes së kontratës Ref: KE-997/15 e lidhur me datën 14.12.2015 dhe aneks kontratën ( për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës pyjore) e lidhur me datën 26.04.2017 si dhe anulimin e akt- pëlqimeve të pranuar nga e paditura, tani të njejtat akte administrative të shpallura nule dhe pa efekt juridik.

Dhoma e Shkallës së Dytë, qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë e vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm pasi që i njëjti është i bazuar në prova dhe ligj, në tërësi e aprovon, se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës Kontestimore, të cilat shkelje Gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë sipas kompetencës si në vështrim të nenit 44 të LKA-së, në mënyrë të drejtë ka shqyrtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të të paditurës, të atakuar me padi, i cili vendim i ka të përmbledhura argumentet në të cilat është bazuar në arsyetimin e tij, ku janë dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare në të cilat është bazuar, e të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë njëjtë si Gjykata e shkallës së parë i miraton si të drejta dhe ligjore.

Kolegji gjen se bazuar në provat e administruara në gjykatën e shkallës së parë, është vendosur drejt dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për faktet vendimtare dhe bazat ligjore në të cilat bazohet aktgjykimi për refuzimin e kërkesë padisë së paditësit, sepse pa dyshim vërtetohet se, paditësi nuk ju ka përmbajtur kushteve të kontratës Ref: KE-977/15 të datës 14.12.2015, dhe aneks kontratës me ref: KE-239/17 të datës 26.04.2017 të lidhur në mes të Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-Agjencioni Pyjor i Kosovës, ku në nenin 7 të kësaj kontrate përcaktohet se: *“Qiradhënësi, mban të drejtën, që këtë kontratë mund ta shkëpus menjëherë nëse Qiramarrësi i tokës pyjore nuk i përmbush obligimet që dalin nga kjo kontratë, apo edhe tejkalon në çfarëdo mënyre qoftë kushtet e parapara me këtë kontratë”*, ndërsa nga raporti i komisionit i datës 14.05.2018 janë konstatuar shkeljet e bëra nga ana e paditësit, ku në ngastrën kadastrale 475-0, ZK ... në Kaçanik, në parcelën numër 475 ZK është vërtetuar përmes kordinatave të GPS të tipit Garmin 60 csx mbi sipërfaqën e shfrytëzuar, ku ka rezultuar se është bërë shfrytëzimi në terren i sipërfaqës së ngastrës nr. 475-0ZK ... është 7.23 dhe është bërë tejkalim i vijave kufizuese sipas kontratës nr. 977/15 dhe aneks kontratës nr. 236/17 nga 05.00.00 ha në 07.23.00 ha, pra në sipërfaqën e tejkaluar prej 02.23.00 ha, përveç kësaj nuk është vërejtur fidan dhe nuk ka shkarpa (etazhe) e që do të duhet të kishte sipas planit të rikkultivimit. Andaj nga kjo gjendje është konstatuar se Operatori Ekonomik “G...E...” është duke operuar jashtë kordinatave të lejuara sipas kontratës në sipërfaqe prej 02.23.00 ha duke e dëmtuar këtë sipërfaqe dhe po ashtu duke e dëmtuar sipërfaqën e rikultivuar nga i njëjti operator ekonomik, nga kjo kuptohet se paditësi ka vepruar në kundërshtim me kontratën dhe aneks kontratën e lidhur me të paditurën pra i njëjti ka tejkaluar kushtet e parapara me kontratë dhe me të drejtë e paditura e ka shkëputur kontratën.

Pretendimet ankimore të paditësit të theksuara si më lartë, se gjendja faktike nuk është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, po ashtu nuk është zbatuar drejtë e drejta materiale, se e njëjta ka prova të mjaftueshme, andaj gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësim të gabuar të provave etj. Kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore, dhe i refuzon si të pa qëndrueshme apo me ndikim për tu ndryshuar çështja dhe për të vendosur në mënyrë tjetër nga ajo e vendosur në organin administrativ përfundimtar dhe në Gjykatën e shkallës së parë, sepse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë në bazë të provave në shkresa të lëndës e po ashtu ligji material është aplikuar në mënyrë të drejtë.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1041/22, me datë 16.03.2023

**Kryetare e kolegjit,  
Saranda Bogaj Sheremeti**